



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:291770

Datë: 11.04.2024

Numri i dokumentit: 05562619

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Driton Sadiku, me bashkëpunëtoren profesionale Argjelina Prenku, në çështjen penale ndaj të akuzuarit F.F., nga Gjakova, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme KPRK-së), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1716/2023, të datës 24.01.2024, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar me datën 11.03.2024, në prezencën e prokurorit së shtetit Sadri Alija, të dëmtuarës M.Z., dhe përfaqësuesit të saj, avokat Meshari Selimaj, të akuzuarit F.F., dhe mbrojtësi i tij, avokat Teki Bokshi nga Gjakova, i caktuar sipas detyrës zyrtare, me datën 12.03.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 11.04.2024, e përpilojë këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

F.F., nga i ati ... e ëma ..., e vajzërisë ... i lindur me datën ..., në Gjakovë, ku edhe tani banon në rrugën "...", numër ... beqar, ka të kryer shkollën e mesme, punon si rrobaqepës, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ...

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datën 22.11.2023, rreth orës 18:30 minuta, në rrugën "...", në Gjakovë, tek semaforët, i pandehuri duke drejtuar automjetin e tipit "...", me targa ..., ngjyrë e kaltër metalike, nga pakujdesia e në kundërshtim me nenin 149 të Ligjit Nr.05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor, ka rrezikuar pjesëmarrësit në komunikacion duke vënë në rrezik jetën e njerëzve, në atë mënyrë

që pasi në semafor ndizet drita e gjelbër, i njëjti fillon lëvizjen me veturën e tij në të djathtë të kryqëzimit, ku me rrotën e përparme e godet këmbësoren M.Z., e cila po kalonte në vendkalimin për këmbësorë e të cilës po ashtu i është ndezur drita e gjelbër në semafor, me çka të dëmtuarës i shkakton lëndime të rënda trupore dhe atë thyerje në kërcirin e këmbës së djathtë të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo i mprehtë) të përshkruara si në Akt Ekspertizën mjekoligjore të Dr. M.G., të datës 17.12.2023.

- me këto veprime ka kryer vepër penale rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 40, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70 dhe 370 par.8 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPP-së të akuzuarin e:

G J Y K O N

- I. ME DËNIM ME KUSHT duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuara brenda afatit të verifikimit prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale, si dhe;
- II. Nëse i akuzuari gjatë kohës së verifikimit kryen një apo më shumë vepra penale dënimi me kusht i shqiptuar mund të revokohet.
- III. E dëmtuara M.Z., nga Gjakova, rr. "Yll Morina" blloku 09/19, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.
- IV. DETYROHET i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej njëzetë (20) euro, si dhe taksën për programin për kompensimin e viktimave të krimit në shumën prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë me datën 24.01.2024, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1716/23, të datës 24.01.2024, ndaj të akuzuarit F.F nga Gjakova, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 11.03.2024 në të cilën seancë kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Sadri Alija, e dëmtuara M.Z., së F.F., dhe përfaqësuesi i tij avokat Teki Bokshi, i caktuar sipas detyrës zyrtare, në të cilin shqyrtim prokurori i shtetit ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës duke propozuar që i akuzuari të shpallet fajtores dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari F.F gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se ka qenë pakujdesi e tij e cila ka ndodhur për shkak të kushteve klimatike, duke shtuar se ndien keqardhje për veprën penale dhe se të dëmtuarës i kërkon falje, me premtimin se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe të mos kryej vepër tjetër a po të njëjtë penale.

Prokurori i shtetit, Anton Hasanaj duke dhënë mendim rreth pranimi të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit duke konsideruar se janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 242 të KPP-së, po ashtu ky pranimi i fajësisë ka mbështetje edhe në provat e bashkangjitura aktakuzës, i akuzuari ka kuptuar pasojat dhe benefitet e pranimi të fajësisë dhe atë pas konsultimit me të mbrojturin e tij, gjykatës i ka propozuar që të aprovoi pranimin e fajësisë. Po ashtu gjykatës i ka propozuar që të pandehurin ta shpallë fajtorë dhe ta dënoj komfor nenit 38 KPRK-së, me anë të cilit do të arrihet qëllimi i dënimit. Njeherit gjykatës i ka propozuar që të marrë parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë dhe faktin se janë pajtuar me të dëmtuarën, ndërsa si rrethanë rënduese të merre lëndimin të cilin e ka marrë e dëmtuara nga ky incident. Po ashtu të njëjtin ta obligoj në pagesën e shpenzimeve procedurale.

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar avokat Meshari Selimaj duke dhënë mendim rreth pranimi të fajësisë ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë së bërë nga ana e të

pandehurit ashtu që mbi këtë bazë pala e dëmtuar nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale, si dhe ka deklaruar se paraqet kërkesë pasurore.

M.z. deklaroi se e mbështetë fjalën e përfaqësuesit të autorizuar të saj.

Mbrojtësi i të pandehurit avokat Teki Bokshi duke dhënë mendim lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se në bazë të konsultimeve me të mbrojturin e tij të pandehurit F.F., ka deklaruar se e pranon fajësinë, ka shtuar se duke pasur parasysh se janë përmbushur kushtet për pranimin e fajësisë gjykatës i ka propozuar që të aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehuri. Ndërsa sa i përket rrethanave lehtësuese ka deklaruar se faktin se vepra në fjalë është kryer nga pakujdesia, në rrethanat e vështira në komunikacion, se i akuzuari nuk ka të kaluar kriminale, se ka shprehur keqardhje për kryerjen e kësaj vepre penale dhe se me një dënim të kushtëzuar do të arrihej qëllimi i dënimit.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 242 të KPP-së. Gjatë pranimi të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve të majftueshme me mbrojtësin e tij av. Teki Bokshi, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 248 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i akuzuari F.F., nga pakujdesia ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 370 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale rrezikimi i trafikut publik e kryen; *“Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt dëm të konsiderueshëm pasuror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet”*. Në paragrafin 6 është paraparë se; *“Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.”* Ndërsa në paragrafin 8 është parashikuar forma e kualifikuar e kësaj vepre penale, ku përcaktohet se; *“Nëse vepra penale nga paragrafi 6. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose dëm pasuror në vlerë prej njëzetmijë (20.000) euro apo më shumë, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.”*

5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Duke u bazuar në këto që janë cekur më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën është ngarkuar, ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Si rrethana lehtësuese që janë marrë për bazë me rastin e matjes së dënimit të shqiptuar ndaj të akuzuarit, gjykata i ka marrë për bazë këto rrethana: rrethanat e tij personale, se i njëjti është i moshës relativisht të re, se gjendja e tij ekonomikë është e dobët dhe është i vetmi në familje që punon si rrobaqepës dhe me te ardhurat që realizon mban familjen e tij, përkatësisht nënën, gjyshen dhe motrën e tij; kërkim faljen, pendimin dhe keqardhjen e shprehur për këtë veprë; faktin që është hera e parë që bie ndesh me ligjin, ku në bazë të të dhënave nga evidenca penale nuk rezulton se më herët ka kryer ndonjë veprë penale, gjithashtu edhe në deklarin e tij në shqyrtim fillestar ka deklaruar kjo është hera e parë që ka kryer një veprë penale dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris më ndonjë veprë penale, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar për veprën penale për të cilën ngarkohet.

Ndërsa, rrethana rënduese përtej elementeve të veprës penale gjykata nuk konstatoi në këtë rast.

Kështu që duke marr parasysh rrethanat e lartpërmendura, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 i KPRK-së dhe ky dënim si i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Kërkesa pasurore juridike

Gjyqtari i vetëm gjykues duke u bazuar në nenin 462 par. 2 të KPP-së, të dëmtuarën e udhëzoi në kontest civil për realizimin e kërkesës së tij juridiko-pasurore.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor është marrë bazuar në nenin 452 par.1 të KPP-së, ndërsa për taksën për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 36 par.3 nën par.3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 364 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

2023:012452, me datën 11.04.2024

Bashkëpunëtorja profesionale,
Argjelina Prenku

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Driton Sadiku

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditëve pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.